



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2020:137474

Datë: 22.04.2021

Numri i dokumentit: 01718463

P.nr. 156/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetëme gjykuese Sabrije Rraci, në çështjen penale kundër të pandehurve R. (S.) G., nga fsh. K., për shkak të veprës penale „Vjedhje” nga neni 313 par. 1 të PKRK-së, dhe B. I. G. nga fsh.K., për shkak të veprës penale, vjedhje nga neni 313 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP.II.nr. 1569/2020 të dt. 13.10.2020, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurores së shtetit Lumturije Vuqetaj, nga Prokuroria Themelore në Pejë dhe të pandehurve të lartëcekur, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar më dt. 23.03.2021, në të njëjtën ditë publikisht shpalli, kurse me datën 22.04.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1.R. G.: i biri i S. dhe nënës Xh., e vajzërisë F., i lindur më dt....., në fshatinK., ku dhe tani jeton, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjës së dobët ekonomike, punëtor i sigurimit, identifikohet me nr. personal, i nacionaliteti, Shqiptarë, Shtetas i Republikës së Kosovës.

2.B. G.: i biri i I. dhe nënës H., e vajzërisë B., i lindur më dt....., në fshatinK., ku dhe tani jeton, i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjës së mesme ekonomike, bujk, identifikohet me nr. personal, i nacionaliteti, Shqiptarë, Shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse:

I pandehuri R. G.

I. Mes datës 14/15.05.2020, rreth orës 20:00-06 min në fsh.K., dhe atë pikërisht në hapësirën e firmës „.....” I.I.C me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete merr sendin dhe atë 280 m. Tel gjembor nga rrethoja e firmës në fjalë, pronë e të dëmtuarit B. D., në atë mënyrë që në kohën e lartëcekur i pandehuri duke shfrytëzuar mungesën e të dëmtuarit dhe punëtorve të tij meqenëse ka qenë kohë pandemie dhe nuk ka punuar firma në fjalë, i njëjti ka shkuar në vëndin e sipërshtënuar dhe nga aty ka marrë sendet e përshkuara si më lart e duke përdor të njëjtin për ta thurur arën e vet.

- Më qka ka kryer veprën penale „vjedhje” nga neni 313 par. 1 të PKRK-së.

II. pandehuri B. G.

Mes datës 14/15.05.2020, rreth orës 20:00-06 min në fsh.K. Klinë, dhe atë pikërisht në hapësirën e firmës „.....” I.I.C me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete merr 16 shtylla metali, nga rrethoja e firmës në fjalë, pronë e të dëmtuarit B. D., në atë mënyrë që në kohën e lartëcekur i pandehuri duke shfrytëzuar mungesën e të dëmtuarit dhe punëtorve të tij meqenëse ka qenë kohë pandemie dhe nuk ka punuar firma në fjalë, i njëjti ka shkuar në vëndin e sipërshënuar dhe nga aty ka marrë sendet e përshkruara si më lart e duke përdor të njëjtin për ta rrethuar kopshtin e tij.

- Më qka ka kryer veprën penale „vjedhje” nga neni 313 par. 1 të PKRK-së.

Andaj gjykata, duke vepruar në kuptim të nenit: 7,8,9,10,17,21,38,40,43, 50,51,69,70,dhe neni 313 par.1 të KPRK, si dhe neni 359,360,361,365,366,450 të KPPRK, i shqipton.

G J Y K O N

DËNIM GJOBË

Të akuzuarit:

1.R. G., Gjkata i përcakton dënimin me gjobë në shumën prej **150 (njëqind e pesëdhjetë) Euro**, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën e shqiptuar sipas afatit të dhënë, e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, konform neni 46 par.3 të KPRK-së, ku një ditë burgim do ti llogaritet në 20 uro të gjobës.

1.B. G., Gjkata i përcakton dënimin me gjobë në shumën prej **150 (njëqind e pesëdhjetë) Euro**, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj gjobën e shqiptuar sipas afatit të dhënë, e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burg, konform neni 46 par.3 të KPRK-së, ku një ditë burgim do ti llogaritet në 20 uro të gjobës. Dhe:

DËNIM ME KUSHT

1.R. G.,e dënon me dënim Burgu në kohëzgjatje prej 3 (tre), muaj i cili dënim, nuk do të ekzekutohen në afatin prej 1 (një) viti, në qoftë se i pandehuri gjatë kësaj kohe nuk do të kryej vepër të re penale

2.B. G.,e dënon me dënim Burgu në kohëzgjatje prej 3 (tre), muaj i cili dënim, nuk do të ekzekutohen në afatin prej 1 (një) viti, në qoftë se i pandehuri gjatë kësaj kohe nuk do të kryej vepër të re penale

II.OBLIHOHEN: Të akuzuarit secili veq e veq qe në emër të shpenzimeve paushalle të paguajnë nga 20 (njëzet) Euro, si dhe shumën me nga 30 Euro, në emër të tarifës për kopmpenzim të viktimave të krimit secili, nga **50 € (pesëdhjet) €**, brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

UDHËZOHET: Pala e dëmtuar B. (F.) D., nga rr. „.....” nr. 35 “.....” qe kërkesën pasurore juridike ta realizoi në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, në këtë gjykatë ka ngritë aktakuzën PP.II.nr.284 /2021 të dt. 12.02.2021, për të pandehurit:, R. (S.) G., nga fsh.K., për shkak të veprës penale „Vjedhje” nga neni 313 par. 1 të PKRK-së, dhe B. I. G. nga fsh.K., për shkak të veprës penale, vjedhje nga neni 313 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me dt.01.04.2021 në prezencë të prokurores së shtetit Lumturije Vuqetaj, pas leximit të aktakuzës, i pandehurit R. G., u deklarua se e pranoi fajësinë për veprën penale qe i vihet në barrë, poashtu edhe i pandehuri B. G. u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale qe i vihet në barrë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga dy të pandehurit dhe pa presion nga askush. Të pandehurit premtuan secili veq e veq se në të ardhmën nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjajshme penale.

Prokurorja e Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë, në fjalën e dhënë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë pasi që pranimi i fajësisë është dhënë në mënyrë vullnetare nga dy të pandehurit dhe me vetëdije të plotë për pasojat e pranimit të fajësisë, pasi që ky pranim është bërë konform dispozitave të KPPRK-së, neni 248.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht, me liri të plotë nga ana e të akuzuarve, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori shtetit.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve, dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërtetoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit me aktvendim,në shqyrtimin fillestar.

Andaj Gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërtetoi se me **veprimet inkriminuese të akuzuarve** përmbushen të gjitha elementet qenësore të **veprës penale „vjedhje” nga neni 313 par. 1 të PKRK-së, e për çka gjykata gjeti se të akuzuarit** në aspektin penal-juridik janë përgjegjës, për çka edhe u shpallën fajtorë dhe iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në llojin dhe masën e dënimit, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i pandehuri, R. G. gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ishte i sinqertë gjatë gjyqimit, dhe ndien keqardhje për veprimet e tij për të cilët edhe i kërkon falje gjykatës, faktin se është hera e parë që ka ra në kundërshtim me ligjin, premtimin se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin. Ndërsa rrethanë rënduese gjykata gjeti dashjën e kryerjës së veprës penale

Edhe i pandehuri B. G. e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ishte i sinqertë gjatë gjykimit, dhe ndien keqardhje për veprimet e tij për të cilët edhe i kërkon falje gjykatës, faktin se është hera e parë që ka ra në kundërshtim me ligjin, premtimin se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin Ndërsa duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana rënduese gjykata gjeti dashjën e kryerjës së veprës penale.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pajtim me nenin 38 të KPRK-së, si dhe në pengimin e të pandehurve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Duke u bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësorë si në dispozitiv të aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par. 3 nënpar. 3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË-DEGA KLINË
P.nr.156/2020 më dt.22.04./2021

Sekretare Juridike
Shere Desku

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prisinë, e nëpërmes kësaj gjykate.